

VENDIM
Nr.419, datë 27.2.2006

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “ERI A&A”

SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ERI A&A” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 375, datë 30.11.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “ERI A&A” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetin e Ballshit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj